



Advocacy Training & Resource Center

Raporti Vjetor 2010 ►

Annual Report 2010 ►





Advocacy Training & Resource Center
Raport vjetor 2010

PËRMBAJTJA

Përmbajtja

Letër nga Drejtori Ekzekutiv	3
Për ATRC	4
Misioni	5
Partnerët	6
Përkrahësit	7
Programi për Ngritje Kapacitetesh	8
Konsulentat individuale	9
Programi për menaxhim të granteve	10
Programi për avokim	11
Monitorimi i procesit të kthimit të zhvendosurve nga vendet e treta	12
Lëvizja Regjionale për Mjedis “BELLS”	13
Zgjidhja e Konfliktit Social	14
Ambasadorët e Rinj në Mbrojtje të Mjedisit	15
Praktika te suksesshme - komuna funksionale	16
Trajnimi i anëtarëve të Kuvendit Komunal të Shtërpcës	17
Legalizimi i objekteve pa leje – përfitimet dhe pasojat	18
Programi për informim	19
Raporti Financiar	20
Botimet e ATRC-së	21
Shtypi për ATRC-në	23
Bordi i ATRC-së	24
Stafi i ATRC-së	24

LETËR NGA DREJTORI EKZEKUTIV

Përshëndetje të nderuar miq,

Sikundër është kthyer në traditë, çdo vit ATRC vjen tek ju me përmbledhjen e punës së saj vjetore, duke synuar që përmes tij të komunikoj me ju dhe njëkohësisht t' ju informoj lidhur me zhvillimet, aktivitetet, projektet dhe rezultatet e arrira brenda vitit raportues.

Viti 2010 ka shënuar disa zhvillime të rëndësishme për ATRC , ndër të cilat mund të përmendim ruajtjen dhe avancimin e partneriteteve me organizata vendore dhe ndërkombëtare, zhvillimin e aktiviteteve bazuar në katër programet bazë të saj: Programi i Administrimit të Grantëve, Programi i Ngritjes së Kapaciteteve, Programi i Avokimit dhe Programi i Informimit, duke siguruar dhe garantuar në të njëjtën kohë përmbushjen e rolit dhe misionit të saj si Qendër e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim.

Aktivitetet e organizuara në njërën anë si dhe rezultatet e arritura në anën tjetër dëshmojnë më së miri për përkushtimin dhe angazhimet e stafit të ATRC-së në përmbushjen e obligimeve që dalin nga misioni i saj si dhe ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme dhe të pakursyer të ofruar nga partnerët e saj në terren, si OJQ, institucione lokale, ekspertë lokal, media etj.

ATRC, edhe më tej, do të angazhoj të gjitha kapacitetet e saj, që në përputhje me objektivat e katër programeve bazë, të ndihmoj dhe përkrah organizatat joqeveritare në Kosovë; të forcoj kapacitetet e brendshme të organizatave joqeveritare; të avokoj në institucione lokale dhe nacionale për çështje të interesit të përgjithshëm, të vazhdoj të ruaj dhe forcoj edhe më tej rolin e saj të ndërmjetësimit në mes sektorit të OJQ-ve dhe donatorëve të ndryshëm, duke u bazuar gjithmonë në moton kryesore: “Bringing out the advocate in everyone”

Kushtrim Kaloshi
Drejtore Ekzekutive



PËR ATRC

Që nga themelimi i saj në vitin 2001, ATRC ka ndihmuar OJQ-të Kosovare në profesionalizimin e punës së tyre, artikulimin e kërkesave të tyre dhe ka avokuar tek strukturat qeveritare për çështje me rëndësi për shoqërinë Kosovare.

ATRC realizon qëllimet e veta përmes katër programeve kryesore të saj:

1. Programi i ngritjes së kapaciteteve, i cili synon që përmes trajnimeve dhe ofrimit të konsulencave, të ngris kapacitetet e organizatave joqeveritare në Kosovë në fushën e zhvillimit organizativ, menaxhimit të projekteve dhe në avokim.

2. Programi i administrimit të Granteve, i cili synon të ndihmoj organizatat joqeveritare lokale përmes granteve, duke synuar ndryshime të politikave publike, inicim të ligjeve dhe rregulloreve, praktika të reja në të mirë të publikut, fushata edukimi dhe sensibilizimi për çështje të ndryshme si: mjedisi, të drejtat e pakicave, transparenca dhe llogaridhënia etj.

3. Programi për Avokim- ATRC në partneritet me

organizata tjera në vazhdimësi inicion fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional, duke synuar që problemet e indentifikuara në komunitet t'i kthej në çështje të forta avokimi dhe si rezultat t'i gjej zgjidhjen e merituar.

4. Programi për Informim, mbështet shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, zyrtarëve dhe qytetarëve. Këtë e realizon përmes diskutimeve publike, konferencave, prezantimeve të donatorëve, publikimeve dhe uebfaqes së ATRC-së.

ATRC beson se ndërtimi i koalicioneve dhe partneriteteve ndërsektorale janë shtylla kyçe për arritjen e qëllimit dhe përmbushjen e misionit të saj. Për këtë arsye, ATRC është në bashkëpunim të vazhdueshëm me OJQ të shumta në Kosovë, është pjesë e fushatave avokuese që kanë për qëllim zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje si dhe është pjesë e rrjeteve në nivel lokal, regjional e ndërkombëtar.



MISIONI

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) është organizatë jofitimprurëse Kosovare e cila angazhohet për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendim-marrje, si kusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike dhe stabile rajonale.

ATRC ndihmon në forcimin e rolit të OJQ-ve si agjent të ndryshimit në shoqëri, ngritë kapacitetin e OJQ-








ve dhe iniciativave qytetare që të ndërrmarin fushata avokimi dhe kontribuon në krijimin e institucioneve qeverisëse bazuar ne standardet ndërkombëtare.

ATRC punon me përfaqësues të OJQ-ve, iniciativat qytetare, administratën publike dhe me institucionet politike pa dallim feje, gjinie, etnie, moshe, aftësie, përkatësie politike dhe orientimi seksual.









PARTNERËT

Gjatë vitit 2010 ATRC ka lidhur partneritete me organizata e institucione të ndryshme qeveritare ne nivele lokale dhe nacionale, me organizata joqeveritare Kosovare dhe ndërkombëtare, në inicimin dhe implementimin e projekteve të përbashkëta.

Institucionet dhe agjencitë qeveritare me të cilat ATRC ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe ka bashkëpunuar gjatë vitit 2010:

	23 Komuna te Kosovës, si: Komuna e Prishtinës, Prizrenit, Dragashit, Suharekës, Rahovecit, Malishevës, Pejës, Istogut, Deçanit, Junikut, Gjakovës, Kamenicës, Vitisë, Gracanices, Kllokotit, Ranillukut, Vushtrisë, Shtërpcës, Malishevës, Podujevës, Obiliqit, Gjilanit dhe Ferizajt,
	30 Drejtori Komunale te Arsimit ne 30 komuna te Kosovës,
	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
	Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim hapësinor,
	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit te Kosovës
	Radio Televizioni I Kosovës – RTK
	60 shkolla fillore te 30 komunave te Kosovës

Organizatrat joqeveritare rajonale me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2010:

	The Euclid Network – Londer
	4x4x4 Balkan Bridges- Shkup
	Urban Research institute- URI- Tirana
	Center for Ecology in Energy- Tuzlla
	Green home- Podgorica
	Environment Ambassadors – Beograd
	Center for modern Skills- Beograd
	Environment Forum - EF

Organizatata Joqeveritare lokale me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2010:

1. CCSD-Qendra për Zhvillim të Shoqërisë Civile	Qytetit të Prishtinës	Prishtinë
	Mitrovicë	18. ANP-Aksioni kundër dhunës dhe ndërtimi i paqes
2. CSD-Komunikimi për Zhvillim Social	Gracanicë	Gjilan
3. FWF-Future without fear	Shëtrpce	19. CDK-Qendra për depolitizimin e shoqërisë
4. Arnika	Pejë	Kosovare
5. Star of the Future	Vushtrri	20. OON-Organizata për persona me aftësi të kufizuar
6. Ekovision	Podujevë	Gracanicë
7. Vizioni i Ardhmërisë	Malishevë	21. SPERANZA
8. SHIP-Shoqata Intelektualëve Pavarur	Deçan	22. YAHR-Asociacioni i të Rinjëve për të Drejtat e
9. IQMM- Iniciativa Qytetare për		Njeriut
Mbrojtjen e Mjedisit	Obiliq	Lipjan
10. Endemika	Drenas	23. Futura Plus
11. Elita	Viti	Shëtrpce
12. Qendra Rinore	Prishtinë	24. World of Angels
13. Iniciativa Rinore Përparimtare	Ferizaj	Mitrovicë
14. BCS-Bethany Christian Services	Gjakovë	25. Me dorë në zemër
15. Fortesa	Kamenicë	Mitrovicë
15. KPJ-Klubi për politikë të jashtme	Prishtinë	26. Shoqata e Gruas,
16. Handikap Kosova	Prishtinë	Gjakovë
17. IQMQP-Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e		27. ShVPDK-Shoqata e të Verbërve dhe atyre
		me të Pamë të Dobësuar të Kosovës
		Prishtinë
		28. Liria
		Istog
		29. Eko- Sharri
		Shëtrpce
		30. Ballkan Union
		Gjilan

PËRKRAHËSIT

Përkrahësit e ATRC-së gjatë vitit 2010 në implementimin e projekteve të saj kanë qenë:

<u>Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)</u>	<u>http://www.usaid.gov/kosovo</u>
<u>Agjensioni i Suedisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA)</u>	<u>www.sida.se</u>
<u>Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë</u>	<u>http://pristina.usembassy.gov</u>
<u>Ambasada e Holandës</u>	<u>http://www.nlembassy.org.yu</u>
<u>Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (ISC)</u>	<u>http://www.iscvt.org</u>
<u>Qendra Ndërkombëtare Olof Palme</u>	<u>www.palmecenter.org</u>
<u>Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR)</u>	<u>http://www.unhcr.org</u>
<u>Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)</u>	<u>http://www.ks.undp.org</u>
<u>Academy for Educational Development (AED)</u>	<u>http://www.aed.org</u>
<u>Care international Kosova</u>	<u>http://www.careks.org</u>
<u>Swiss-Kosovo Local Governance and Decentralization Support – LOGOS</u>	<u>http://www.intercoopkos.org</u>



PROGRAMI PËR TRAJNIME DHE NGRITJE KAPACITETESH

Ky program ka pas për qëllim t'iu ofrojë OJQ-ve metodat dhe mjetet e duhura për të iniciuar ndryshime tek komunitetet e tyre. Dita ditës këto organizata ballafaqohen me sfida të reja dhe nevojat e tyre nuk janë të

njëta si më parë, andaj edhe ATRC ka ndryshuar programin e saj duke prezantuar trajnime më të avancuara dhe me tema të reja, në mënyrë që nevojat e përfituesve të saj të reflektohen në këtë program.

Gjatë vitit 2010, trajnerët e ATRC-së në përputhje me kërkesat e partnerëve të saj kanë realizuar 30 trajnime, nga të cilat kanë përfituar OJQ dhe institucione të ndryshme, të të gjitha nacionaliteteve.

Temat e përfshira në Programin e trajnimeve:

- Dizajnimi i projekt propozimit
- Menaxhimi i projektit
- Menaxhimi i OJQ-ve dhe Ngritja e fondeve
- Hyrje në Avokim dhe Ndërtimi i Koalicioneve
- Roli i OJQ-ve në Shoqëri Civile
- Qeverisja e mirë
- Lidershipi dhe Menaxhimi
- Planifikimi Strategjik
- Analiza e Shpenzimeve
- Monitorimi dhe Vlerësimi
- Raportet në mes Mediave dhe Shoqërisë Civile

- Komunikimi Efektiv
- Komunikimi me klient
- Menaxhimi Financiar
- Relacionet me Publikun dhe Marketingu
- Menaxhimi i Konfliktëve
- Negociatat
- Qeverisja me Pjesëmarrje
- Planifikimi kooperues
- Buxhetimi me Pjesëmarrje
- Infrastruktura ligjore që reflekton punën e komunave në Kosovë vendimmarrëse
- Mekanizmat e përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse
- Funksionimi i qeverisë lokale

Shënim: Për të gjithë klientët tanë, pagesat janë të standardizuara dhe janë të bazuara në kohën e kërkuar për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve të trajnimit.



KONSULENCAT INDIVIDUALE

Ndryshe nga trajnimet formale të cilat u dedikohen një audience më të madhe, konsulentat janë të dizajnuara për të adresuar nevojat specifike të individëve dhe organizatave në mënyrë të veçantë. Për këtë arsye, ATRC praktikon metodën e kombinimit të dy shërbimeve: trajnimet me konsulencë individuale, duke përmbushur sa më mirë nevojat e çdo përfituesi dhe njëkohësisht për të ngritur efektivitetin e programit të saj.

Gjatë vitit 2010, janë zhvilluar 80 konsulencë individuale në çështje që kanë të bëjnë me shkrim të projekt propozimeve, zhvillim organizativ, menaxhim dhe ngritje të fondeve, zgjidhje konflikti, ndërmjetësim etj.



PROGRAMI PËR MENAXHIM TË GRANTEVE

Në kuadër të projektit për Fuqizim të Shoqërisë Civile në Kosovë, të menaxhuar nga ISC përmes fondeve të USAID, ATRC së bashku me tri organizatat partnere të saj: Qendrën për Zhvillim të Shoqërisë Civile (CCSD) në Mitrovicë, Komunikimi për Zhvillim Social (CSD) në Gracanicë dhe Ardhmëria pa Frikë (FWF) në Shtërpce, kanë ndarë dhe administruar 18 grante OJQ-ve kosovare, të dedikuara për avokim në nivel lokal.

Projektet janë përqëndruar kryesisht në fushata avokimi në nivele lokale, duke synuar ndryshime të politikave publike, inicim të rregulloreve të reja lokale, praktika të reja komunale në të mirë të publikut, fushata edukimi dhe sensibilizimi për çështje të ndryshme si: mjedisi, të drejtat e pakicave, transparenca dhe llogaridhënia etj.

Pasqyra e projekteve të shpërblyera me grante:

Bethany Christian Services (BSC) – Gjakovë

Pjesëmarrja e komunitetit RAE në implementimin e strategjisë për vitet 2009-2015

FORTESA – Kamenicë

Komunikimi mes qeverisë lokale dhe qytetarëve, nëpërmjet këshillave lokal

Shoqata e të Verbërve dhe atyre me të Pamë të Dobësuar të Kosovës - Prishtinë

E drejta për qasje të lirë

Liria - Istog

Ngrite zërin

Shoqata e Personave me Paralizë të Fëmijëve, Handikap Kosova - Prishtinë

Monitorimi i implementimit të planit nacional të veprimit për persona me aftësi të kufizuara

Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Qytetit të Prishtinës (IQMQP) - Prishtinë

Fushatë preventive kundër degradimit të qytetit të Prishtinës

ELITA - Viti

Komuna në shërbim të qytetarëve

CDKD

Mbrojeni Natyrën dhe Natyra do t'ju mbroj juve

Aksioni kundër dhunës dhe ndërtimi i paqes (ANP) - Gjilan

Eja të ndryshojmë diçka

Organizata për persona me aftësi të kufizuara (OON)-Gracanicë

Asgjë mos bëni për ne, pa ne

SPERANZA -Mitrovicë

Fushatë avokimi për ngritjen e kapaciteteve dhe punësimin e rasteve sociale

Asociacioni i të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut (YAHR) - Lipjan

Krijimi i mekanizmave për pjesëmarrje të komuniteteve të fshatrave në komunën e Lipjanit

Futura Plus – Shtërpce

Zyra shërbyese për qytetarë

World of Angels - Mitrovicë

Ne kemi të drejtë për punë

Klubi për politikë të jashtme - Prishtinë

Kosova në internet

Me dorë në zemër - Mitrovicë

Pjesëmarrja aktive e qytetarëve, në procesin vendimmarrës në nivelin komunal ndikon në qeverisjen e mirë

Shoqata e Gruas – Gjakovë

Përpilimi i “Rregullores për Eko – Taksat “ në Komunën e Gjakovës



PROGRAMI PËR AVOKIM

Për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në zhvillimin e institucioneve dhe praktikave demokratike, ATRC në partneritet me organizata tjera dhe e vetme, në vazhdimësi inicion fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional, duke synuar që problemet e indentifikuara në komunitet t'i kthej në çështje të forta avokimi dhe si rezultat t'i gjej zgjidhjen e merituar. Programi për avokim gjithashtu siguron një platformë për rrjetëzim, shkëmbim informatash dhe aktivizim me OJQ-të tjera nga Kosova dhe rajoni.

Gjatë vitit 2010, ATRC ka qenë e përfshirë në këto projekte:

- Monitorimi i procesit të kthimit të zhvendosurve nga vendet e treta
- Lëvizja regjionale për ambient "BELLS"
- Zgjidhja e Konfliktit Social
- Ambasadorët e Rinj në Mbrojtje të Mjedisit
- Praktika te suksesshme - komuna funksionale
- Legalizimi i objekteve pa leje-përfitimet dhe pasojat



MONITORIMI I PROCESIT TË KTHIMIT TË ZHVENDOSURVE NGA VENDET E TRETA

Edhe gjatë vitit 2010, vazhdoi projekti për monitorimin e Aeroportit të Prishtinës, i cili financohet nga UNHCR.

Projekti ka si objektiv monitorimin e procesit të kthimit të detyruar dhe vullnetar të azil kërkuesve Kosovar nga vendet e treta në Kosovë.

Përmes këtij projekti, ekipi monitorues i ATRC-së arrin të identifikoj të gjitha rastet të cilat janë kthyer në mënyrë të detyruar apo vullnetare, duke përcjellur në vazhdimësi trendet e të kthyerve në Kosovë dhe qëndrueshmërinë e këtyre kthimeve.

Ekipi i monitoruesve të ATRC gjatë vitit 2010 është vizituar nga Eurodeputetja austriake Ulrice Lunacek, e cila shpehu interesin e saj në lidhje me punën dhe angazhimet e stafit të ATRC-së në monitorimin e pro-

cesit të kthimit të zhvendosurve në përgjithësi dhe angazhimet dhe përkujdesja që personat e kthyer marrin nga institucionet relevante pas kthimit në Kosovë --në veçanti.



LËVIZJA REGJIONALE PËR MJEDIS “BELLS”

Viti 2010 është karakterizuar me shtim të numrit të aktiviteteve të orientuara në dhe rreth çështjeve të mjedisit, disa prej të cilave janë organizuar nga ATRC në cilësinë e partnerit implementues për Kosovë të Lëvizjes Rajonale Mjedisore BELLS, në kuadër të projektit: Regional Environmental Advocacy / REA Action and Cohesion in Western Balkans), i përkrahur nga Ambasada Mbretërore e Holandës.

Projekti ka për qëllim ngritjen e vetëdijes të vendimarrësve dhe akterëve të tjerë me rëndësi, për nevojën e përmirësimit të legjislacionit për ambient, vënien e çështjes së mjedisit në krye të agjendave qeveritare si dhe zhvillimin e fushatave avokuese për inicim të politikave publike, ligje, vendime praktika dhe procedura, të cilat do të krijojnë përmirësim të mjedisit në nivele nacionale dhe rajonale.

Gjatë vitit 2010 janë organizuar një varg konferencash me temë mjedisore: “Dita Nërkombe e Ujit”, “Dialogu ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare në procesin e integritimit evropian”, “Vlerat dhe Standardet e UE-së për Mjedis, takime ndërparlamentare Maqedoni – Kosovë dhe Shqipëri, Konferenca Regjionale mes partnerëve të BELLS-it, në Beograd, Mal të Zi, Kosovë dhe Maqedoni dhe janë shpallur 6 Ambasador të Mjedisit për Kosovë.

Aktivitet tjetër ishte edhe nënshkrimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me 12 kryetarët e komunave (Prishtinë, Drenas, Malishevë, Viti, Kastriot, Shtërpce, Ferizaj, Pejë, Gjilan, Podujevë, Vushtrri dhe Deçan) si dhe janë organizuar aktivitete avokuese mjedisore nga



organizatat lokale në 12 komuna, me qëllim të rritjes së angazhimeve të përbashkëta: Komunë-OJQ për zhvillimin e politikave publike mjedisore.

Marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar edhe me Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis, si dhe me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Gjithashtu është realizuar Peticioni me rreth 8000 qyterarë si dhe 400 përfaqesues të institucioneve lokale në 12 Komuna të Kosovës, i cili më pas i është përcjellur Institucioneve të Kosovës.



ATRC Raporti Vjetor 2010

Partnerët implementues të Lëvizjes Rajonale Mjedisore BELLS:

ATRC – Prishtinë
Instituti për Hulumtime Urbane URI - Tiranë
Qendra për Ekologji dhe Energji - Tuzël
4x4x4 Urat Ballkanike -Shkup
Shtëpia e Gjelbër - Podgoricë
Qendra për Aftësi Moderne - Beograd

ZGJIDHJA E KONFLIKTIT SOCIAL

ATRC edhe këtë vit ka vazhduar implementimin e projektit “Zgjidhja e konfliktit social”, i financuar nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, i cili ka për qëllim t’i ndihmojë qeverisë lokale dhe shoqërisë civile të nxisë dhe fuqizoj marrëdhëniet në mes tyre në mënyrë që të parashikojë dhe t’i përgjigjet më mirë nevojave të komunitetit.

Projekti është implementuar në 6 komuna të Kosovës: Gjakovë, Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik. Fillimisht ATRC ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me komunat e lartpërmendura, për të vazhduar më pas me organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe zyrtarët komunal, duke synuar kështu rritjen e bashkëpunimit në mes këtyre dy sektorëve.

Gjatë periudhës mars-qershor 2010 ATRC ka realizuar 12 trajnime dy ditore me temë “Qeverisja me pjesëmarrje” dhe “Planifikimi kooperues”. Pas përfundimit të trajnimeve, me përkrahje të komunave dhe në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues të Bashkësive Lokale, Zyrave të Vendit, përfaqësues të fshatrave dhe qytetarë, ATRC ka identifikuar nevojat e banorëve të komunës së Gjakovës, Pejës, Klinës, Istogut, Deçanit dhe Junikut për vitin 2011-2012. Rezultatet e dalja janë bërë publike në konferencat për media të organizuara në çdo komunë.

Përmes këtyre aktiviteteve, ATRC ka synuar që të rris bashkëpunimin në mes komunave dhe qytetarëve, t’u ofrojë mundësinë qytetarëve që të shprehin lirshëm kërkesat dhe rekomandimet e tyre dhe të ushtrojnë presionin demokratik në institucionet lokale për marrjen në konsideratë të kërkesave të tyre gjatë hartimit të planeve komunale, si dhe t’u ndihmoj institucioneve lokale në procesin e hartimit të buxhetit komunal, duke i ofruar të dhëna konkrete për secilin fshat veç e veç.



AMBASADORËT E RINJ NË MBROJTJE TË MJEDISIT



Projekti është implementuar në 30 komuna të Kosovës, respektivisht në 60 shkolla fillore, duke synuar ndryshime pozitive në çështje të mjedisit përmes aftësimit të nxënësve të klasëve të pesta të shkollave fillore. Në kuadër të këtij projekti, të financuar nga Ambasada Amerikane në Kosovë, u realizuan një sërë aktivitete të cilave u parapriu nënshkrimi i marrëveshjeve për bashkëpunim me 30 drejtorë të drejtorive komunale për arsim. U organizuan ligjërata me temë "Fëmijët në mbrojtje të Mjedisit" në 60 shkolla fillore të 30 komunave të Kosovës dhe po me të njëjtnë temë u organizua edhe ekspozita pamore në Prishtinë, me ç'rast u ekspozuan 60 vepra artistike dhe u dhanë edhe Mirënjohjet për veprat më të mira. Vazhdimësi e

projektit ishte edhe certifikimi i 300 Ambasadorëve të Vegjël të Mjedisit, nga mbarë Kosova, të cilët u angazhuan në zbatimin e 60 granteve për çështje mjedisore, të shpërndara në 30 komuna.

Në këtë projekt nuk munguan as debatet televizive, me ç'rast u organizuan disa sosh. Të pranishëm në debate ishin drejtorë të shkollave fillore dhe nxënës të klasave të pesta, të cilët prezantuan para audiencës kosovare angazhimet e tyre rreth mjedisit dhe gjendjen mjedisore në shkolla. Projekti u përmbyll me 15 konferenca mjedisore ku fëmijët paraqitën shqetësime për shkak të moskujdesit adekuat për ruajtjen e mjedisit dhe njëkohësisht dhanë rekomandime për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen.



PRAKTIKA TE SUKSESSHME - KOMUNA FUNKSIONALE

Projekti “Praktika të suksesshme komuna funksionale” ka për qëllim ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile dhe zyrtareve komunal të tri komunave të reja: Graçanicë, Klllokot dhe Ranillugë dhe Forcimin e bashkëpunimit ndërkomunal: komunë e re – komunë amë, përmes adaptimit dhe aplikimit të praktikave dhe procedurave të sukseshme nga komunat amë tek ato të reja.

Me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve të planifikuara në këtë projekt, të përkrahur nga fondet e USAID-it, ATRC fillimisht nënshkroi Marrëveshje Bashkëpunimi me komunat amë dhe komunat e reja: Prishtinë, Graçanicë, Viti, Klllokot, Kamenicë dhe Ranillugë. Në vazhdim gjatë muajve shtator – nëntor 2010 ATRC realizoi 9 trajnime me temat “Infrastruktura ligjore që reflekton punën e komunave në Kosovë”, “Qeverisja me Pjesëmarrje” dhe “Mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse”. Pjesëmarrës në këto trajnime ishin anëtarë të Kuvendit Komunal, zyrtarë të komunës dhe përfaqësues të Shoqërisë civile të komunës së Graçanicës, Klllokotit dhe Ranillugës.



Ndërkohë, gjatë muajit dhjetor ATRC organizoi 3 vizita studimore me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile nga komuna e re tek organizatat simotra të komunave amë, me qëllim të shkëmbimit të shembujve të mirë të suksesit në komunikim me strukturat komunale dhe ndihmën që OJQ-të mund të ofrojnë në këtë proces.



TRAJNIMI I ANËTARËVE TË KUVENDIT KOMUNAL TË SHTËRPCËS



Në kuadër të partneritetit me Organizatën Gjermane: “Christian Schwarz – Schilling Project” – CSSP, dhe ATRC organizuan në Strugë të Maqedonisë trajnimin treditor për anëtarët e Kuvendit Komunal të Shtërpcës, i përqendruar në Qeverisjen Lokale dhe raportin në mes Komunës dhe qytetarëve.

Trajnerët e ATRC-së gjatë tre ditëve, u sqaruan anëtarëve të Kuvendit Komunal të Shtërpcës dokumentet bazë të funksionimit të Komunave, si:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës
- ligjet të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt ose indirekt me komunat,
- dokumentet tjera komunale të cilat janë obligative për komunat
- mënyrat e bashkëpunimit të komunës me qytetarë
- raportet komunë-ministri
- përgjegjësitë e komunave (vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara) etj.

LEGALIZIMI I OBJEKTEVE PA LEJE – PËRFITIMET DHE PASOJAT



Me qëllim të informimit të qytetarëve të komunës së Prishtinës, lidhur me procedurat e aplikimit, afatet kohore, dokumentacionin etj, ATRC dhe Komuna e Prishtinës me përkrahje nga ISC përmes fondeve të USAID, organizuan takime informative me qytetarë në nëntë zona të qytetit të Prishtinës, në të cilat kanë marrë pjesë rreth 1000 qytetarë.

Takimet kishin për qëllim informimin e qytetarëve të Komunës së Prishtinës në përgjithësi në lidhje me procesin e filluar të aplikimit për legalizim të objekteve

pa leje në Prishtinë.

Si rezultat i këtyre takimeve dhe rekomandimeve të dala nga qytetarët, Komuna e Prishtinës zgjati afatin për aplikim edhe për dy muaj – nëntor dhe dhjetor 2010, hoqi gjobën prej 30% për ndërtuesit ilegal si dhe ktheu njësinë matëse të hapësirës së banimit nga metri kub në metër katror.



PROGRAMI PËR INFORMIM



ENGLISH :: SHQIP :: SRPSKI

Fillimi | Sitemap | Login | Email

Për Ne

Informimi

Grante

Trajnimet

Shërbimet

Shërbimet e Trajnimeve dhe Konsulentës

Si organizatë në shërbim, për trajnime dhe përkrahje për OJQ-të, ATRC ofron programe trajnimesh dhe konsulencia, të dizajnuara për ballafaqimin e nevojave aktuale dhe nevojave të vazhdueshme të klientëve tanë. Shërbimet tona përfshijnë trajnime dhe konsulencia bazike dhe të avancuara në fushat kryesore të zhvillimit organizativë, menaxhimit të projektit dhe avokim.

LIDHJET

→ Programet e ATRC-se

→ Deklaratat Financiare

→ Diskutimet Publike

→ Donatorët & Partnerët

KONFERENCA, TRYEZA E RRUMBULLAKËT DHE NGJARJE PUBLIKE

- Konferenca Kombetare
Vlerat dhe standardet mjedisore të BE-së Më shumë...
- Tryeza e Rrumbullakët
Prezantimi i Platformave Politike për Mjedisin Më shumë...
- Konferenca nder-komunale
"Vepra me seriozitet –Parandalo ethe hemorragjike!"
Më shumë...
- Tryeza e rrumbullakët kombëtare
"Ujë të pastër për Botë me të shëndetshme" Më shumë...
- Konferenca Rajonale

INFORMIM

::Takimi Regjional:
"Zbatimi i ligjeve dhe
standardeve të BE-së në
nivel lokal"
24-26 shkurt 2011Budva

::ATRC ka nënshkruar
marrëveshje bashkë-
punimi me 6 Komuna të
Kosovës

::ATRC-ja ndihmon 60
shkolla fillore të Kosovës

::ATRC trajnon anëtarët

Programi i ATRC-së për informim, mbështet shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, zyrtarëve dhe qytetarëve. Këtë e realizon përmes diskutimeve publike, konferencave, prezantimeve të donatorëve, publikimeve dhe uebfaqes së ATRC-së.

Buletini "Avokuesi"

ATRC vazhdon publikimin e buletinit elektronik "Avokuesi" i cili përmban udhëzime dhe informata praktike që OJQ-të dhe grupet e tjera të interesuara mund t'i përdorin gjatë punës së tyre.

Biblioteka

Biblioteka e ATRC-së posedon më shumë se 1.060 tituj librash, raportesh dhe materiale të tjera në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe për avokim, shoqëri civile, lidhshmëri, të drejtat e njeriut, mjedis, vetëdijësim gjinor, etj.

ATRC ka ridizajnuar uebfaqen duke e bërë atë më të përshtatshme për shfrytëzuesit në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe. Në vitin 2010, uebfaqja është vizituar 17.038 herë.

RAPORTI FINANCIAR



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Bordit të Drejtorëve të Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

Ne kemi audituar pasqyrat përcjellëse financiare të Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC-së, të cilat përfshijnë bilancin e gjendjes më 31 Dhjetor 2010, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, pasqyrën e rrjedhës së parave për vitin që u mbyll, dhe shënimet tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm, në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme me rrethanat.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim të marrjes së provave të auditimit për vlerat dhe shpalsjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të ekzistencës së gabimeve në pasqyrat financiare, qofshin ato rezultat i mashtrimeve apo pasaktësive. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë, ofrojnë bazë të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të ATRC-së më 31 dhjetor 2010, dhe rezultatin e aktivitetit të saj për fundin e vitit, në përputhje me politikat kontabël të aprovuara në Republikën e Kosovës.

Arment Osaj Auditor ligjor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
Mars 2011




Raportin e Auditimit mund ta shkarkoni nga web faqja zyrtare e ATRC-se: www.advocacy-center.org

BOTIMET E ATRC-SË

PLANIFIKIMI ME PJESËMARRJE - Prioritetet e banorëve të regjionit të Prizrenit.

Ky botim prej 152 faqesh, përmban prioritetet e banorëve të Regjionit të Prizrenit, përkatësisht të Komunës së Prizrenit, Suharekës, Rahovecit, Dragashit dhe të Malishevës. Publikimi u përkrah nga Olof Palme.



PLANIFIKIMI ME PJESËMARRJE - Prioritetet e banorëve të regjionit të Pejës, Gjakovës, Deçanit, Itogut, Klinës dhe Junikut.

Edhe ky botim, përmban prioritetet e banorëve të Regjionit të Pejës, përkatësisht të Komunës së Pejës, Gjakovës, Deçanit, Itogut, Klinës dhe Junikut, si dhe u përkrah nga i njëjti donator.



“BRINGING OUT THE ADVOCATE IN EVERYONE”

Kjo broshurë ofron një pasqyrë të përgjithshme për profilin e ATRC-së, përfshirë shërbimet që ofron kjo organizatë. Gjithashtu lexuesi mund të informohet lidhur partneritetin e ATRC-së me rrjete të organizatave, lokale, rajonale dhe në nivel evropian.



FËMIJËT NË MBROJTJE TË MJEDISIT

Ky libër ngërthen në vete të gjitha aktivitetet mjedisore të realizuara në komunat e Kosovës, kryesisht në shkollat fillore. Botimi u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë.




VEPRIMI RAJONAL DHE KOHEZIONI NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Kjo fletushkë ofron për lexuesit hulumtimin e kryer nga REA në kuadër të projektit rajonal për dy vjet “Mbrojtje edukative për mjedisin – veprimet dhe kohezionit e Ballkanit Perëndimor”.



RAPORTI VJETOR 2009

ATRC ka botuar raportin përmbledhës të punës së saj vjetore 2009. I përgatitur në tri gjuhë: shqip, serbisht, anglisht, ky botim ofron një pasqyrim të aktiviteteve dhe të arritjeve kryesore të ATRC-së gjatë vitit 2009.



Të gjitha publikimet mund të mirren në zyret e ATRC-së

shkon shkollat



Kisha ka dhënë dhjetë miliona dollarë për të rindërtuar shkollat në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit të Jugut.

Peshkopi i Pejës dhe shërbëtorët e tij në shkollat e rindërtuara.

Mbeturinat e mjekësisë ngufatin qytetin

Pa, 12 shtator - Mjekësia e rëndësishme në Kosovë ka mbeturinatat e mjekësisë ngufatin qytetin.



Mbeturinat e mjekësisë ngufatin qytetin. Mjekët në spitalin e Pejës janë të shtrirë për shkak të mungesës së mjekëve dhe mjekëve të tjerë që kanë mbeturinatat e mjekësisë ngufatin qytetin.

Mjekësia e rëndësishme në Kosovë ka mbeturinatat e mjekësisë ngufatin qytetin. Mjekët në spitalin e Pejës janë të shtrirë për shkak të mungesës së mjekëve dhe mjekëve të tjerë që kanë mbeturinatat e mjekësisë ngufatin qytetin.

Shkollat

problem nacional

Problemi i shkollave në Kosovë është një problem nacional që kërkon zgjidhje të menjhëhershme.



Shkollat në Kosovë janë të rindërtuara dhe të rinovuara për të siguruar një nivel më të lartë të arsimit.

Problemi i shkollave në Kosovë është një problem nacional që kërkon zgjidhje të menjhëhershme. Shkollat në Kosovë janë të rindërtuara dhe të rinovuara për të siguruar një nivel më të lartë të arsimit.

Mbeturinat e mjekësisë ngufatin qytetin. Mjekët në spitalin e Pejës janë të shtrirë për shkak të mungesës së mjekëve dhe mjekëve të tjerë që kanë mbeturinatat e mjekësisë ngufatin qytetin.

Mbeturinat e mjekësisë ngufatin qytetin. Mjekët në spitalin e Pejës janë të shtrirë për shkak të mungesës së mjekëve dhe mjekëve të tjerë që kanë mbeturinatat e mjekësisë ngufatin qytetin.

Mbeturinat e mjekësisë ngufatin qytetin. Mjekët në spitalin e Pejës janë të shtrirë për shkak të mungesës së mjekëve dhe mjekëve të tjerë që kanë mbeturinatat e mjekësisë ngufatin qytetin.

Fëmijët në mbrojtje të mjedisit

Më shumë fëmijë në mbrojtje të mjedisit në Kosovë. Qendra e Trajnimeve dhe e Botimeve për Avokatin prezanton raportin e saj të ri.

Më shumë fëmijë në mbrojtje të mjedisit në Kosovë. Qendra e Trajnimeve dhe e Botimeve për Avokatin prezanton raportin e saj të ri.

Më shumë fëmijë në mbrojtje të mjedisit në Kosovë. Qendra e Trajnimeve dhe e Botimeve për Avokatin prezanton raportin e saj të ri.

Më shumë fëmijë në mbrojtje të mjedisit në Kosovë. Qendra e Trajnimeve dhe e Botimeve për Avokatin prezanton raportin e saj të ri.

Gazeta - Bota Sot

Fermocentralet ndotin njëjtë rendet e rajonit

Fermocentralet ndotin njëjtë rendet e rajonit. Kjo tregon se fermerët në Kosovë janë të barabartë dhe të integruar në tregun lokal.

Fermocentralet ndotin njëjtë rendet e rajonit. Kjo tregon se fermerët në Kosovë janë të barabartë dhe të integruar në tregun lokal.

Fermocentralet ndotin njëjtë rendet e rajonit. Kjo tregon se fermerët në Kosovë janë të barabartë dhe të integruar në tregun lokal.

Fermocentralet ndotin njëjtë rendet e rajonit. Kjo tregon se fermerët në Kosovë janë të barabartë dhe të integruar në tregun lokal.

Fermocentralet ndotin njëjtë rendet e rajonit. Kjo tregon se fermerët në Kosovë janë të barabartë dhe të integruar në tregun lokal.

Fermocentralet ndotin njëjtë rendet e rajonit. Kjo tregon se fermerët në Kosovë janë të barabartë dhe të integruar në tregun lokal.

Organizata Kosovare, Qendra e Trajnimeve dhe e Botimeve për Avokatin prezanton raportin e saj të ri për ATRC-në

Më shumë fëmijë në mbrojtje të mjedisit në Kosovë. Qendra e Trajnimeve dhe e Botimeve për Avokatin prezanton raportin e saj të ri.

Më shumë fëmijë në mbrojtje të mjedisit në Kosovë. Qendra e Trajnimeve dhe e Botimeve për Avokatin prezanton raportin e saj të ri.

Më shumë fëmijë në mbrojtje të mjedisit në Kosovë. Qendra e Trajnimeve dhe e Botimeve për Avokatin prezanton raportin e saj të ri.

Më shumë fëmijë në mbrojtje të mjedisit në Kosovë. Qendra e Trajnimeve dhe e Botimeve për Avokatin prezanton raportin e saj të ri.

Më shumë fëmijë në mbrojtje të mjedisit në Kosovë. Qendra e Trajnimeve dhe e Botimeve për Avokatin prezanton raportin e saj të ri.

BORDI I ATRC-SË

KRESHNIK BERISHA

Themelues i ATRC-së
Kryetar i Bordit

ADRIANA KABASHI

Redaktore në RTK
Nënkryetare e Bordit

VJOSA MULLATAHIRI

Menaxhere e Projektit në UNDP
Anëtare e Bordit

Prof. Dr. ISA ELEZAJ

Profesor në Fakultetin e Shkencave Natyrore në UP
Anëtar Bordi

NAIM RASHITI

Hulumtues /Menaxher i zyrës në ICG
Anëtar Bordi

PERSONELI I ATRC-SË

Drejtor Ekzekutiv

Kushtrim Kaloshi

kushtrimk@advocacy-center.org

Drejtor i Programeve

Donika Podrimja Salihu

donika@advocacy-center.org

Menaxher i Financave dhe Administratës

Gani Asllani

gani@advocacy-center.org

Menaxhere e Programit të Trajnimeve dhe
Konsulencave

Nora Susuri

nora@advocacy-center.org

Koordinatorë e Projektit

Shukrije Rama

shukrije@advocacy-center.org

Asistente e Projektit

Sanije Goxhufi

sanije@advocacy-center.org

Asistente e Projektit

Bojana Delibasic

bojana@advocacy-center.org

Koordinatorë e Ekipit për Monitorimin
e të Kthyerve

Emine Emini

emine_e@advocacy-center.org

Monitorues deri në qershor 2010

Gëzim Kunoviku

gezim@advocacy-center.org

Monitorues nga qershori 2010

Magbule Pllana

magbule@advocacy-center.org

Monitorues

Hysen Hamzaj

hysen@advocacy-center.org

Monitorues

Zaid Kulinxha

zaid@advocacy-center.org

TI & Administratë

Arsim Kosumi

arsim@advocacy-center.org

Asistente Administrative

Jehona Tmava

jehona@advocacy-center.org



Advocacy Training & Resource Center
Annual Report 2010

CONTENTS

CONTENTS

A Letter from the Executive Director	3
About ATRC	4
Mission	5
Partners	6
Supporters	7
Program for development of capacities	8
Individual consultancies	9
Program for management of grants	10
Advocacy program	11
Monitoring the process of the return of displaced persons from third countries	12
Regional environmental movement "BELLS"	13
Social conflict resolution	14
New ambassadors for the protection of environment	15
Successful practices – functional municipalities	16
Training Municipal Assembly members of Shtërpçë	17
Legalization of buildings without construction permits – benefits and consequences.....	18
Program on information	19
Financial Report	20
ATRC publications	21
The press about ATRC	23
Board of ATRC	24
Staff of ATRC	24

A LETTER FROM THE EXECUTIVE DIRECTOR

Greetings to my dear friends,

As if it has become a tradition that every year ATRC approaches you with its annual working summary, aiming at communicating with you through the summary and at the same time informing you on developments, activities, projects and results achieved within the reporting period.

Year 2010, marked some important developments for ATRC, of which can be mentioned; keeping and advancing of partnerships with domestic and international organizations; development of activities according to its four basic programs: Program of Administration of Grants, Program of development of capacities, program of Advocacy and program of information, at the same time ensuring and guaranteeing the accomplishment of the role and its mission as an Advocacy Training and Resources Centre.

The activities organized on one hand and the results achieved on the other hand prove it best, the commitment and engagement of ATRC staff in accomplishment of obligations arising from its mission, assistance, and constant and generous support from its partners on the ground, as NGOs, local institutions, local experts, media, etc.

ATRC will further engage all its capacities, in accordance with four basic programs. Assist and support Non-governmental organizations in Kosovo. Strengthen internal capacities of Non-governmental organizations. Advocate at local and national institutions on the issues at the general interest, and to continue to keep and to further strengthen its advocacy role among NGO sectors and various donators, always according to the main motto: “Bringing out the advocate in everyone”

Kushtrim Kaloshi
Executive Director



ABOUT ATRC

Ever since its establishment in 2001, ATRC has helped Kosovo NGOs in making their work professional, articulating their requests and has advocated to governmental structures on the issues important for the Kosovo society.

ATRC has been accomplishing its aims through four of its main programs:

